



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 24, DATË 15.04.2020

MBI

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT PERSON FIZIK ALBAN SHEHU,  
LICENCUAR PËR SUBJEKTIN AUDIOVIZIV "TV BERATI", PËR SHTYRJEN E  
AFATIT TË PAGESËS SË MBËSHTETJES NË RRJETIN NUMERIK TË RTSH-SË**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

- Kërkues:** Subjekti person fizik Alban Shehu analogë privatë ekzistues, të licencuar për të ofruar shërbim analog licencuar për subjektin audioviziv "Tv Berati".
- Objekt:** Ndërmjetësim me operatorin publik (RTSH) për shtyrjen e afatit të pagesës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së
- Baza Ligjore:** Neni 19, pika 1, germa h dhe pika 16 e ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

VËREN

Pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), pas situatës së krijuar prej pandemisë së krijuar prej infeksionit COVID-19, prej disa subjekteve audio/audiovizive janë paraqitur kërkesa për lehtësi/mbështetje të karakterit financiar.

Ndër kërkesat e ardhura, përfshihet edhe kërkesa e depozituar në adresën elektronike të AMA-s, prej subjektit person fizik Alban Shehu, licencuar për subjektin audioviziv "TV Berati".

Subjekti në kërkesën e tij e tij, thekson se:

*"... duke marrë parasysh situatën e pandemisë nga COVID-19, ju bej me dije se aktualisht Berati TV po punon me staf shumë të reduktuar, kemi anuluar edhe emisionet përveç atyre informative. Të gjitha kompanitë që bënin marketing tek ne i kane anuluar kontratat për shkak të situatës së jashtëzakonshme dhe si rrjedhojë kemi mbetur pa te ardhura, të pa mundur për të paguar as punonjësit.*

*Në këtë situatë jashtëzakonisht të vështirë, ju lutemi të na përjashtoni së paku përkohësisht nga detyrimi për pagesën e sinjalit ndaj RTSH (930 euro) deri në përmirësim të situatës dhe kthimit të normalitetit.*

*Bëj me dije se ne paguajmë rregullisht prej 2017 dhe subvencionimin e vitit të parë të transmetimit ende nuk e kemi marrë të plotë. “*

AMA vëren se tarifat e mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së janë miratuar nga AMA me vendimin nr. 54, datë 29.03.2016 dhe midis subjektit dhe RTSH-së është lidhur kontrata e mbështetjes ku palët kanë dakordësuar kushtet teknike, financiare, ligjore, etj.

AMA mban parasysh pasojat e ardhura për shkak të pandemisë së krijuar prej infeksionit të shkaktuar prej infeksionit COVID-19,

### **PËR KËTO ARSYE**

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa h dhe pika 16 e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **V E N D O S I:**

1. T’i propozojë Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) pranimin e kërkesës së subjektit person fizik Alban Shehu, licencuar për subjektin audioviziv “Tv Berati”, për shtyrjen e afatit të pagesës së mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së, deri në përmirësimin e situatës së krijuar prej pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**